

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 19624 Akt.

1924

V E N D I M

PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot, më datën 14.06.1998, unë Jane Kreskari, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Tiranë, pasi studiova materialet e paraqitura për regjistrimin e Shoqërisë Tregtare "ALBANIA TABAK FABRIKA E RE E CIGAREVE" SH P K.

K O N S T A T O V A S E :

Nga ana e zotit Vebi Velija, si shtetas kroat, është themeluar Shoqeria Tregtare "ALBANIA TABAK FABRIKA E RE E CIGAREVE" SH P K, dhe janë hartuar dhe nënshkruar prej tij aktet perkatese. Ndërsa nga ana e zotit Kristaq Koti, i emëruar si Administrator i Vetëm, është paraqitur Kërkesa për regjistrimin e Shoqërisë Tregtare si person juridik.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë :

Zhvillimi i importimit, eksportimit dhe tregtimit të të gjitha llojeve të mallrave. Grumbullimi, përpunimi, seleksionimi, fermentimi, magazinimi, transporti i duhanit dhe çdo veprim tjetër që lidhet me aktivitetin e duhanit. Prodhimi, importimi, eksportimi dhe tregtimi i cigareve si dhe çdo veprim tjetër që lidhet me aktivitetin e cigareve.

Kryerja e investimeve në të gjitha fushat dhe kryesisht për ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, në infrastrukture, etj..

Zhvillimi dhe kryerja e aktivitetit të shërbimeve, kërkimeve, konsulences, projekteve dhe studimeve të të gjitha llojeve.

Realizimi i kontratave, marrëveshjeve, ortakërive, shoqërive të përbashkëta apo i formave të tjera të lejuara nga legjislacioni shqiptar, me persona fizikë dhe juridikë, shqiptarë ose të huaj, për të realizuar operacione industriale, tregtare, financiare dhe veprimtari të ndryshme që janë të nevojshme dhe me interes për Shoqërinë si dhe çdo lloj aktiviteti që do t'i shërbejë realizimit të objektit të Shoqërisë.

Selia e Shoqërisë do të jetë në Librazhd, në Lagjen Nr.1.

Administratori i vetëm i Shoqërisë do të jetë zoti Kristaq Koti.

Kapitali themeltar do të jetë 1.000 \$ (njemije dollare USA).

Shoqëria do të vazhdojë veprimtarinë e saj me një afat të pacaktuar, por sidoqofte mbi 10 vjet.

Duke e konsideruar kerkesen te drejte dhe te mbeshtetur ne ligj, në bazë të Ligjit Nr.7638, datë 19.12.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe Ligjit Nr.7667, date 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare",

V E N D O S A :

Regjistrimin si person juridik te Shoqërisë Tregtare "ALBANIA TABAK FABRIKA E RE E CIGAREVE" SH P K, me Ortak te Vetem zotin Vebi VELIJA, si shtetas kroat.

Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jene :

Zhvillimi i importimit, eksportimit dhe tregtimit te te gjitha llojeve te mallrave. Grumbullimi, perpunimi, seleksionimi, fermentimi, magazinimi, transporti i duhanit dhe cdo veprim tjeter qe lidhet me aktivitetin e duhanit. Prodhimi, importimi, eksportimi dhe tregtimi i cigareve si dhe cdo veprim tjeter qe lidhet me aktivitetin e cigareve.

Kryerja e investimeve ne te gjitha fushat dhe kryesisht per ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, ne infrastrukture, etj..

Zhvillimi dhe kryerja e aktivitetit te sherbimeve, kerkimeve, konsulences, projekteve dhe studimeve te te gjitha llojeve.

Realizimi i kontratave, marrëveshjeve, ortakërive, shoqërive të përbashkëta apo i formave të tjera të lejuara nga legjislacioni shqiptar, me persona fizikë dhe juridikë, shqiptarë ose të huaj, për të realizuar operacione industriale, tregtare, financiare dhe veprimtari të ndryshme që janë të nevojshme dhe me interes për Shoqërinë si dhe çdo lloj aktiviteti që do t'i shërbejë realizimit të objektit të Shoqërisë.

Selia e Shoqërisë do të jetë në Librazhd, ne Lagjen Nr.1.


Administratori i Vetëm i Shoqërisë do të jetë Zoti Kristaq KOTI.

Kapitali themeltar do të jetë 1.000 \$ (njemije dollare USA).

Kohezgjatja e Shoqerise do te jete me afat te pacaktuar, por sidoqofte mbi 10 vjet.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit.

G J Y Q T A R E



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Vendimi nr. 19624/1

Nr. Akti 7993

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM
-PER DEPOZITIM AKTESH TE PERSONIT JURIDIK-

Sot me 06.12.1999, une [Signature], Gjyqtare prane Gjykates se Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga ortaku i vetem i shoqerise Albania Tabak Fabrika e re e Cigareve Shpk, per regjistrimi e ndryshimeve ne kollonat perkatese te regjistrimit tregtar dhe depozitimin ne aneksin e tij, te vendimit te Ortakut te Vetem te shoqerise Albania Tabak Fabrika e re e Cigareve Shpk, date 06.12.1999, dhe dokumenteve te tjera perkatese nga te cilet:

KONSTATOVA:

Shoqeria Albania Tabak Fabrika e re e Cigareve Shpk. me ortak te vetem Z. Vebi Velija, eshte regjistruar si person juridik ne regjistrin tregtar, me vendimin nr.19624 date 17.06.1998, te Gjykates se Rrethit Tirane.

Me date 06.12.1999, administratori i vetem i shoqerise Z. Kristaq Koti, nepermjet vendimit te marre prej tij dhe te aprovuar nga ortakut i vetem i shoqerise ka komunikuar doreheqjen e tij te parevokueshme nga detyra e administratorit te shoqerise si dhe nga te gjitha funksionet e tjera ne kete shoqeri.

Po keshtu, me date 06.12.1999, ortakut i vetem i shoqerise Albania Tabak Fabrika e re e Cigareve Shpk., Z. Vebi Velija ka njoftuar vendimin e tij per pranimin e doreheqjes se administratorit te meparshem Z. Kristaq Koti dhe ka vendosur emerimin e administratorit te ri Z. Agim Arapi shtetas shqiptar, lindur ne Elbasan me 18.08.1954, banues ne adresen Lagja e Re, Rruga Rinia, Pall: 501/1, Elbasan, mbajtes i pasaportes nr.0173882, duke filluar nga data 06.12.1999.

Gjithashtu konstatova se kerkesa per regjistrimin e faktit te mesiperm dhe depozitimin e akteve perkatese ne regjistrin tregtar, eshte e bazuar ne ligj, dhe

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare",

VENDOSA:

Pranimin e kerkeses.
Depozitimin e vendimit te administratorit Kristaq Koti per te dhene doreheqjen nga detyra e administratorit te shoqerise Albania Tabak Fabrika e re e Cigareve Shpk., date 06.12.1999, te vendimit te ortakut te vetem te shoqerise Z. Vebi Velija po te dates 06.12.1999 per emerimin e administratorit te ri Z. Agim Arapi;
Urdherohet zyra e Regjistrimit Tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen VLL, germa ___ si dhe te behet ndarja nga njeri-tjetri me vize te kuqe.

GJYQTARE
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 19624/e i VENDIMIT

VENDIM

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 30.11. 2001, ne Tirane, une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane E. Bep pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Bilbil Alimadhi, per depozitim e dokumentave per ndryshime ne Statutin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " Albania Tabak Fabrika e Re e Cigareve " shpk.

V E R E J :

Se shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " Albania Tabak Fabrika e Re e Cigareve " sh.p.k.Librazhd, eshte rregjistruar si person juridik me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr.19624 date 17.06.1998 me Ortak te Vetem z.Vebi Velija.
Me Vendimin e dates 12.07.2001 Ortaku i Vetem i shoqerise ka vendosur:

- 1- Shkarkimin e administratorit te shoqerise z. Agim Arapi.
- 2- Emerimin e z. Bilbil Alimadhi ne postin e administratorit te shoqerise "Albania Tabak Fabrika e Re e Cigareve" sh.p.k.
- 3- Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane

Nga dokumentat e paraqitura rezulton se kerkesa e tij eshte e drejte dhe perputhje me ligjin e Statutin dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 dhe Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993,

V E N D O S A

- 1- Pranimin e kerkeses.
- 2- Depozitim prane Rregjistrat Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane te Vendimit te Ortakut te Vetem te shoqerise "Albania Tabak Fabrika e Re e Cigareve" shpk date 17.11.2001.
- 3- Urdherimin e zyres se Rregjistrat Tregtar te beje ndryshimet ne skeden e shoqerise ne kollonen _____.

GJYQTARE

E. Bep
Ardu

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Në Tiranë, sot më datë 23 3 .2002, unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë
E.3, pasi mora në shqyrtim kërkesën e kërkuarit Bilbil Alimadhi,
administratori shoqërisë "Albania Tabak Fabrika e re e Cigareve " sh.p.k.

K O N S T A T O R A

Se shoqëria "Albania Tabak Fabrika e re e Cigareve " sh.p.k. është regjistruar si person
juridik me vendimin nr. 19624 date 17.06.98 të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Ortak i Vetëm i shoqërisë është z.Vebi Velija.

Ortaku i Vetëm i shoqërisë me Vendimin nr. 4 datë 24.12.2001 ka vendosur:

1. Te rrisë kapitalin themeltar te shoqërisë.
2. Te emerojë z. Teit Gjini si ekspert kontabel i autorizuar për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë.

Kërkesa e tij është e drejtë, e bazuar në ligj e në Statut dhe duhet pranuar.

P E R K E T O A R S Y E

Në bazë të Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993

V E N D O S A

Pranimin e kërkesës.

Depozitim në Rregjistrin Tregtar të Vendimit Nr.4 datë 24.12.2001 të Ortakut të
Vetëm të shoqërisë "Albania Tabak Fabrika e re e Cigareve " sh.p.k.

Te emerojë z. Teit Gjini si ekspert kontabel të autorizuar për vlerësimin e zmadhimit të
kapitalit të shoqërisë.

Urdhërimin e Zyrës së Rregjistrimit Tregtar të bëjë shënimet përkatëse në skedën e
shoqërisë në kollonën _____.

GJYQTARE

E.3

(Signature)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 19624 VENDIMI

VENDIM

I GJYQTARIT TE VETEM

Në Tiranë, sot më datë 8. 4. 2002, unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë E. 3p, pasi mora në shqyrtim kërkesën e kërkuarit Bilbil Alimadhi, administrator i shoqërisë "Albania Tabak Fabrika e re e Cigareve" sh.p.k.

KONSTATOVA

Se shoqëria "Albania Tabak Fabrika e re e Cigareve" sh.p.k. është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 19624 datë 17.06.98 të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Ortak i Vetëm i shoqërisë është z.Vebi Velija.

Ortaku i Vetëm i shoqërisë me Vendimin nr. 5 datë 27.03.2002 ka vendosur:

1. Te aprovoje raportin e ekspertit kontabel të autorizuar z. Teit Gjini për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë.
2. Te rrisë kapitalin themeltar të shoqërisë nga 1,000 (njemije) USD në 226,612,035 (Dyqindenzetegjashtemilion e gjashteqindedyshjetemije e tridhjetepese) Leke.
3. Numri i kuotave në kapitalin themeltar do të bëhet, 453 (katerqindpesedhjetetere) kuota, ndërsa vlera nominale e një kuote do të jete 500,000 (peseqindmije) leke.
4. Neni 12 i statutit të shoqërisë të ndryshohet si më poshtë: "Kapitali themeltar i shoqërisë është 226,612,035 (Dyqindenzetegjashtemilion e gjashteqindedyshjetemije e tridhjetepese) Leke. Ky kapital mund të shtohet të pakesohet ose të transferohet në përputhje me statutin e shoqërisë si dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi."

Kërkesa e tij është e drejtë, e bazuar në ligj e në Statut dhe duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Në bazë të Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993

VENDOSA

Pranimin e kërkesës.
Depozitim në Regjistrin Tregtar të Vendimit Nr.5 datë 27.03.2002 të Ortakut të Vetëm të shoqërisë "Albania Tabak Fabrika e re e Cigareve" sh.p.k. dhe të aktit të ekspertimit për vlerësimin e kontributeve për zmadhimin e kapitalit.

Urdhërimin e Zyrës së Rregjistrit Tregtar të bëjë shënimet përkatëse në skedën e shoqërisë në kollonën ____.

GJYQTARE

E. Bep

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 19624/6 VENDIMIT

VENDIM

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot më datë 28.5.2002,në Tiranë, unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë M. Dogan, pasi mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuesi Rudolf Papa,për depozitimin e dokumentave për ndryshime në Statutin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Albania Tabak Fabrika e Re e Cigareve" shpk Librazhd.

KONSTATOVA:

Se shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Albania Tabak Fabrika e Re e Cigareve" sh.p.k. Librazhd, është rregjistruar si person juridik me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr.19624 date 17.06.1998 me Ortak të Vetëm z.Vebi Velija.
Me Vendimin e datës 18.05.2002 Ortaku i Vetëm i shoqërisë ka vendosur:
1- Shkarkimin e administratorit të shoqërisë z. Bilbil Alimadhi.
2- Emërimin e z.Rudolf Papa në postin e administratorit të shoqërisë "Albania Tabak Fabrika e Re e Cigareve" sh.p.k. Librazhd.
3- Pasqyrimin e këtyre ndryshimeve në Rregjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Nga dokumentat e paraqitura rezulton se kërkesa e tij është në përputhje me ligjin e Statutin dhe duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Në bazë të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 dhe Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993,

VENDOSA

- 1- Pranimin e kërkesës.
- 2- Depozitimin pranë Rregjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë të Vendimit të Ortakut të Vetëm të shoqërisë "Albania Tabak Fabrika e Re e Cigareve"shpk Librazhd datë 18.05.2002, për emërimin e administratorit të ri z.Rudolf Papa.
- 3- Urdhërimin e Zyrës së Rregjistrin Tregtar të bëjë ndryshimet në skedën e shoqërisë në kollonën _____.

GJYQTAR
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 19624/6i VENDIMIT

VENDIM

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot më datë 13.09- 2002, në Tiranë, unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë M. Gjeor, pasi mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuuesi Ylli Haskurti, për depozitimin e dokumentave për ndryshime në Statutin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Albania Tabak Fabrika e Re e Cigareve" shpk Librazhd.

KONSTATOVA:

Se shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Albania Tabak Fabrika e Re e Cigareve" sh.p.k. Librazhd, është rregjistruar si person juridik me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr.19624 date 17.06.1998 me Ortak të Vetëm z.Vebi Velija.
Me Vendimin e datës 6.09.2002 Ortaku i Vetëm i shoqërisë ka vendosur:

1. Shkarkimin e administratorit të shoqërisë z.Rudolf Papa.
2. Emerimin e z.Ylli Haskurti në detyrën e administratorit të shoqërisë "Albania Tabak Fabrika e Re e Cigareve" sh.p.k.
3. Përveç kompetencave të shprehura në Statut, Administratori do të realizojë administrimin, drejtimin e përfaqesimit të shoqërisë në të gjitha marrëdhëniet, veprimet, procedurat me organet administrative shtetërore, seancat gjyqësore ose administrative, si dhe pajtime e kompromise. Në të gjitha marrëdhëniet e tjera me palë të treta firma dhe përfaqësimi i shoqërisë i takon Ortakut të Vetëm të shoqërisë.
4. Pasqyrimin e ndryshimeve në Rregjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Nga dokumentat e paraqitura rezulton se kërkesa e tij është në përputhje me ligjin e Statutin dhe duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Në bazë të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 dhe Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993,

VENDOSA

- 1- Pranimin e kërkesës.
- 2- Depozitimin pranë Rregjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë të Vendimit të Ortakut të Vetëm të shoqërisë "Albania Tabak Fabrika e Re e Cigareve" shpk

Librazhd datë 6.09.2002, për emërimin dhe kompetencat e administratorit të ri z.Ylli Haskurti.

3- Urdhërimin e Zyrës së Rregjistrimit Tregtar të bëjë ndryshimet në skedën e shoqërisë në kollonën 4.

GJYQTARE

Mariamp

Dech

Adrian

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
Nr. 19624/18 i Vendimit

VENDIM
I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 18/06 2005, une G. S. J., gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mora ne shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkuarit Isuf DERVISHI, me cilësinë e administratorit të shoqërisë tregtare "Albania Tabak Fabrika e RE e Cigareve" sh.p.k., mbi depozitimin e vendimit të ortakut te vetem, për emerimin e administratorit,

KONSTATOVA SE :

Shoqëria Tregtare "Albania Tabak Fabrika e RE e Cigareve" sh.p.k. është rregjistruar si person juridik ne baze te vendimit Nr. 19624, date 17. 06. 1998 te Gjykeses se Shkalles se Pare, Tiranë.

Kërkuarisi, Isuf Dervishi, me cilësinë e administratorit të kesaj shoqërie tregtare kërkon depozitoje e vendimit të ortakut te vetem, datë 07. 06. 2005, me anën e të cilit është vendosur :

1. Te shkarkohet administratori aktual Z. Ylli HASKURTI.
2. Emerimin e Z. Isuf DERVISHI, si administrator te Shoqerise "Albania Tabak Fabrika e Re e Cigareve" sh.p.k.
3. Depozitimin e ketij vendimi ne Regjistrin Tregtar,

Për sa më sipër, kërkesa e paraqitur për depozitimin e vendimit të ortakut te vetem të shoqërisë "Albania Tabak Fabrika e Re e Cigareve" sh.p.k, datë 01.09.2004, është plotësisht e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të ligjit nr.7667, datë 28.01.1993 "Për Rregjistrin Tregtar",

VENDOSA :

1. Pranimin e kerkeses.
2. Depozitimin e vendimit datë 07. 06. 2005 të Ortakut te Vetem te Shoqerise "Albania Tabak Fabrika e Re e Cigareve" sh.p.k., me ane te cilit eshte vendosur:
 - Te shkarkohet administratori aktual Z. Ylli HASKURTI.
 - Emerimin e Z. Isuf DERVISHI, si administrator te Shoqerise "Albania Tabak Fabrika e Re e Cigareve" sh.p.k.
3. Te behen shenimet perkatese prane Zyres se Regjistrin Tregtar ne skeden e Shoqerise.

Kundër vendimit lejohet ankimi sipas ligjit.

GJYQTARE

Qulula Ruj

Effer

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË
Nr. 19624/8 i Vendimit

VENDIM
I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 13 10. 2005, une, A. Cocco, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mora ne shqyrtim kërkesen e bërë nga ana e kërkuarit, Isuf DERVISHI, me cilësinë e administratorit të shoqërisë tregtare "Albania Tabak Fabrika e Re e Cigareve" sh.p.k., mbi depozitimin e vendimit të Asamblese së Jashtezakonshme të Ortakut,

KONSTATOVA SE :

Shoqëria Tregtare "Albania Tabak Fabrika e RE e Cigareve" sh.p.k. është regjistruar si person juridik në baze të vendimit Nr. 19624, datë 17. 06. 1998 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë. Ortak i vetëm është Z. Vebi Velija, i cili zoteron 100% të kuotave në kapitalin themeltar.

Kërkuari, Isuf DERVISHI, me cilësinë e administratorit të kësaj shoqërie kërkon të depozitojë vendimin e Asamblese së Jashtezakonshme të Ortakut të kësaj shoqërie të datës 10. 10. 2005, me anën e të cilit është vendosur:

- Perthithja e shoqërisë "ALBANIA TABAK" sh.p.k. nga ana e Shoqërisë "ALBANIA TABAK FABRIKA E RE E CIGAREVE" sh.p.k.
- Rritja e kapitalit themeltar të Shoqërisë nepermjet :
 - perthithjes së shoqërisë "ALBANIA TABAK" sh.p.k.
 - heqjes dore nga kerkimi i detyrimeve që Shoqëria "VEVE GROUP" sh.p.k. ka ndaj Shoqërisë.
 - nepermjet primeve të kapitalit.
- Kerkohet caktimi nga gjykata I eksperteve Luan Kamberi dhe Diana Golemi.
- Depozitimi i këtij vendimi në Regjistrin Tregtar.

Per kete qellim, shoqëria, që kërkon të perthithet "Albania Tabak" sh.p.k., e cila është e regjistruar me vendimin nr. 5926, dt. 25. 08. 1994, me ane të vendimit të ortakut të vetëm të saj, që I bashkangjitet kësaj praktike, ka dhënë miratimin për perthithjen e kësaj shoqërie.

Për sa më sipër kërkesa e paraqitur është plotësisht e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të ligjit nr.7667, datë 28.01.1993 "Për Rregjistrin Tregtar",

V E N D O S A :

1. Pranimin e kërkeses.
2. Depozitimin e Vendimit të Asamblese së Jashtëzakonshme të Ortakut të Shoqërisë "Albania Tabak Fabrika e re e Cigareve" Sh.p.k.,, datë 10. 10. 2005, me anë të të cilit është vendosur:
 - Perthithja e shoqërisë "ALBANIA TABAK" sh.p.k. nga ana e Shoqërisë "ALBANIA TABAK FABRIKA E RE E CIGAREVE" sh.p.k
 - Rritja e kapitalit themeltar të Shoqërisë nepermjet :
 - perthithjes së shoqërisë "ALBANIA TABAK" sh.p.k.
 - heqjes dore nga kerkimi i detyrimeve që Shoqëria "VEVE GROUP" sh.p.k. ka ndaj Shoqërisë.
 - nepermjet primeve të kapitalit.
3. Caktohen ekspertet Luan Kamberi dhe Diana Golemi për për gatitjen e raportit për ktates.

Kundër vendimit lejohet ankimi sipas ligjit.

G J Y Q T A R E

Ariana Caco

Asco

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESORË TIRANË
Nr. 18624 i Vendimit
18

VENDIM
I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 18 10. 2005, une, A. Ceca gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë, mora ne shqyrtim kërkesen e bërë nga ana e kërkuarit, Isuf DERVISHI, me cilësinë e administratorit të shoqërisë tregtare "Albania Tabak Fabrika e Re e Cigareve" sh.p.k., mbi depozitimin e vendimit të Asamblese se Jashtezakonshme të Ortakut,

KONSTATOVA SE :

Shoqëria Tregtare "Albania Tabak Fabrika e RE e Cigareve" sh.p.k. është regjistruar si person juridik në baze të vendimit Nr. 19624, datë 17. 06. 1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor, Tiranë. Ortak I vetëm është Z. Vebi Velija, i cili zotëron 100% të kuotave në kapitalin themeltar.

Kërkuari, Isuf DERVISHI, me cilësinë e administratorit të kësaj shoqërie kërkon të depozitojë vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme të Ortakut të kësaj shoqërie të datës 16. 10. 2005, me anën e të cilit është vendosur:

- Miratimi i raportit dhe i projektit të bashkimit nëpërmjet përthithjes, i Shoqërisë "ALBANIA TABAK" sh.p.k. nga ana e Shoqërisë "ALBANIA TABAK FABRIKA E RE E CIGAREVE" sh.p.k., sipas raportit dhe projektit të ekspertëve kontabel.
- Miratimi i raportit të ekspertëve kontabel për rritjen e kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- Kapitali themeltar i Shoqërisë rritet nga 226 612 035 (dyqindënjzetegjashtë milion e gjashtëqindëdhjetë mijë e tridhjetëpese) leke në 525 000 000 (peseqindënjzetepese milion) leke. Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i ndarë në 1050 kuota, me vlerë 500 000 (peseqind mijë) leke secila, të cilat zotërohen 100% nga ortaku I vetëm z. Vebi Velija.
- Shoqëria përthithet dhe do të vazhdojë të quhet "Albania Tabak Fabrika e re e Cigareve" sh.p.k., me ortak të vetëm z. Vebi Velija, me seli në Librazhd dhe me administrator z. Isuf Dervishi.

Nderkohe qe Asambleja e Jashtezakonshme e Shoqerise "ALBANIA TABAK" sh.p.k., qe kerkon te perthithet, me vendimin e saj te dt. 16. 10. 2005 ka vendosur:

- Miratimi I bashkimit nepermjet perthithjes i Shoqerise "ALBANIA TABAK" sh.p.k. nga ana e Shoqerise "ALBANIA TABAK FABRIKA E RE E CIGAREVE" sh.p.k., sipas raportit te eksperteve kontabel.
- Transferimi I pasurise se shoqerise tek shoqeria perthithese.
- Prishja pa likuidim e shoqerise.

Për sa më sipër kërkesa e paraqitur është plotësisht e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

~~PËR KËTO ARSYE~~

Në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të ligjit nr.7667, datë 28.01.1993 "Për Rregjistrin Tregtar",

V E N D O S A :

1. Pranimin e kerkeses.
2. Depozitimimin e Vendimit të Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakut te Shoqerise "Albania Tabak Fabrika e re e Cigareve" Sh.p.k.,, datë 16. 10. 2005, me ane te te cilit eshte vendosur:
 - Miratimi i raportit dhe i projektit te bashkimit nepermjet perthithjes, i Shoqerise "ALBANIA TABAK" sh.p.k. nga ana e Shoqerise "ALBANIA TABAK FABRIKA E RE E CIGAREVE" sh.p.k., sipas raportit dhe projektit te eksperteve kontabel.
 - Miratimi i raportit te eksperteve kontabel per rritjen e kapitalit themeltar te Shoqerise.
 - Kapitali themeltar i Shoqerise rritet nga 226 612 035 (dyqindenjetegjashte million e gjashteqindedybedhete mije e tridhjetepese) leke ne 525 000 000 (peseqindenjetepese million) leke. Kapitali themeltar I shoqerise do jete I ndare ne 1050 kuota, me vlere 500 000 (peseqind mije) leke secila, te cilat zoterohen 100% nga ortaku I vetem z. Vebi Velija.
 - Shoqeria perthithese do te vazhdoje te quhet "Albania Tabak Fabrika e re e Cigareve" sh.p.k., me ortak te vetem z. Vebi Velija, me seli ne Librazhd dhe me administrator z. Isuf Dervishi.

3. Depozitimën në Regjistrin tregtar të vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të dt. 16. 10. 2005 të Shoqërisë "ALBANIA TABAK" sh.p.k., me anë të të cilit është vendosur:
- Miratimi I bashkimit nëpërmjet përthithjes i Shoqërisë "ALBANIA TABAK" sh.p.k. nga ana e Shoqërisë "ALBANIA TABAK FABRIKA E RE E CIGAREVE" sh.p.k., sipas raportit të ekspertëve kontabel.
 - Transferimi I pasurisë së shoqërisë tek shoqëria përthithëse.
 - Prishja pa likuidim e shoqërisë.
4. Urdhërohet Zyra e Regjistrimit Tregtar të bëjë ndryshimet përkatëse në skedat e shoqërive respektive.
-

Kundër vendimit lejohet ankimi sipas ligjit.

G J Y Q T A R E

Arie me Coco


Uellen Monstrum

- 19624 -

2(e) "ALBANIA TABA 6 Febulo e He e
Cepet " He. P. 6

(b) Libuless, A. Nr 1.

(c) Jumbullon, perunin, elapetun e
tepten; Oculuut, /neolun, impetun
elapetun Ty.

(c) ~~100.00~~ 1.000 Oella amellan
vep Ollote i veten Vellon Vyp.

3. Teluushoto, amelan Kustup
Cob.

4. Hotele onto meclerun me
Alt 11.06. P8

5. 17. 06. 98.

reputo bonus
Nr 6604/3722/01 lapin
Peculo, kus' me 2

medun; ototat ps curon aduushoto NV 681
A. Kuxko

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"ALBANIA TABAK FABRIKA E RE E CIGAREVE" SH P K

Zoti Vebi VELIJA, si shtetas kroat, i biri i Nuriut, i dtl. 29.07.1948, me numër pasaporte 06625298, si themelues i kesaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, në të cilën ai është Ortak i Vetëm, vendosi të hartojë këtë Akt Themelimi, mbështetur në parimet e mëposhtme :

Neni 1

Themeluesi krijon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të cilën do ta quajë "ALBANIA TABAK FABRIKA E RE E CIGAREVE" SH P K.



Neni 2

Selia e Shoqërisë do të jetë në Librazhd, në Lagjen Nr.1.

Me vendim të ortakut të vetëm mund të hapen seli sekondare, filiale ose forma të tjera shoqërishe, ashtu sikundër do ta shohë të nevojshme Shoqëria, brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Neni 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, por sidoqofte mbi 10 vjet dhe do të fillojë nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, me përjashtim të rastit kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos ortakut i vetëm.

Neni 4

Si objekt i veprimtarisë së Shoqërisë do të jenë :

Zhvillimi i importimit, eksportimit dhe tregtimit të të gjitha llojeve të mallrave.

Grumbullimi, përpunimi, seleksionimi, fermentimi, magazinimi, transporti i duhanit dhe çdo veprim tjetër që lidhet me aktivitetin e duhanit. Prodhimi, importimi, eksportimi dhe tregtimi i cigareve si dhe çdo veprim tjetër që lidhet me aktivitetin e cigareve.



Kryerja e investimeve ne te gjitha fushat dhe kryesisht per ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, ne infrastrukture, etj..

Zhvillimi dhe kryerja e aktivitetit te sherbimeve, kerkimeve, konsulences, projekteve dhe studimeve te te gjitha llojeve.

Realizimi i kontratave, marrëveshjeve, ortakërive, shoqërive të përbashkëta apo i formave të tjera të lejuara nga legjislacioni shqiptar, me persona fizikë dhe juridikë, shqiptarë ose të huaj, për të realizuar operacione industriale, tregtare, financiare dhe veprimtari të ndryshme që janë të nevojshme dhe me interes për Shoqërinë si dhe çdo lloj aktiviteti që do t'i shërbejë realizimit të objektit të Shoqërisë.

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë 1.000 \$ (njëmijë dollare USA), i zoteruar i gjithi nga Ortaku i Vetem.

Neni 6

Kapitali themeltar është depozituar prej tij në nje Bankë ne Shqiperi, me një llogari të hapur në emër të Shoqërisë në formim e sipër.

Shuma e depozituar vërtetohet me anë të një çertifikate të lëshuar nga ajo Bankë, në të cilën shënohet shuma e kapitalit të derdhur.

Neni 7

Administrimi i Shoqërise do të behet nga nje Administrator i vetem, kompetencat e te cilit percaktohen ne Statut dhe ne aktin e emerimit te tij.

Neni 8

Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij Akti Themelues edhe me norma të përcaktuara në Statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga Ortaku i Vetëm dhe si i tillë do të miratohet në Gjykatën e Rrethit Tiranë në ditën e legalizimit si person juridik në Shqipëri.

Neni 9

Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (kater) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore.

THEMELUESI

VEBI VELIJA

STATUT

I SHOQERISE PRIVATE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ALBANIA TABAK FABRIKA RE E CIGAREVE" SH P K

KAPITULLI I

EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI

Neni 1 Emri

Shoqëria tregtare private me pergjegjesi te kufizuar emertohet "ALBANIA TABAK FABRIKA E RE E CIGAREVE" SH P K, e cila më poshtë do te quhet "Shoqëria", krijohet nga ortakut i vetëm, si themelues, Zoti Vebi VELIJA, si shtetas kroat i biri i Nuriut, i dtl. 29.07.1948, me numër pasaporte 06625298.

Neni 2 Forma

Kjo Shoqeri eshte nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe i perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.



Neni 3 Baza juridike

Shoqëria krijohet në baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise dhe, si person juridik, e zhvillon aktivitetin ne perputhje me kete legjislacion dhe me normat e ketij Statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Neni 4 Selia

Selia e Shoqërisë është në Librazhd, ne Lagjen Nr.1. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakut të vetëm.



Shoqëria do ta konsiderojë qendrën e vet si Shoqëria Nënë, e cila rast pas rasti do të hapet me anë filialesh ose shoqërish të përbashkëta në të gjitha ato vende ku do të shikojë interes në përmbushjen e qëllimit të saj, në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose edhe jashtë saj.

Neni 5 Territori

Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.

Shoqëria mund të krijojë dege (filiale) ose perfaqesi, si ne rrethe te ndryshme te Republikës se Shqiperise ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

KAPITULLI II OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Neni 6 Objekti

Si objekt i veprimtarisë së Shoqërisë do të jënë :
Zhvillimi i importimit, eksportimit dhe tregtimit të të gjitha llojeve të mallrave.
Grumbullimi, perpunimi, seleksionimi, fermentimi, magazinimi, transporti i duhanit dhe cdo veprim tjetër që lidhet me aktivitetin e duhanit. Prodhimi, importimi, eksportimi dhe tregtimi i cigareve si dhe cdo veprim tjetër që lidhet me aktivitetin e cigareve.

Kryerja e investimeve në të gjitha fushat dhe kryesisht për ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, në infrastrukture, etj..

Zhvillimi dhe kryerja e aktivitetit të shërbimeve, kërkimeve, konsulences, projekteve dhe studimeve të të gjitha llojeve.

Realizimi i kontratave, marrëveshjeve, ortakërive, shoqërive të përbashkëta apo i formave të tjera të lejuara nga legjislacioni shqiptar, me persona fizikë dhe juridikë, shqiptarë ose të huaj, për të realizuar operacione industriale, tregtare, financiare dhe veprimtari të ndryshme që janë të nevojshme dhe me interes për Shoqërinë si dhe çdo lloj aktiviteti që do t'i shërbejë realizimit të objektit të Shoqërisë.

Neni 7 Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar, por sidoqofte mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakut të vetëm.

KAPITULLI III
AUTORITETI I ORTAKUT, LIBRI I SHOQERISE, KONFIDENCIALITETI

Neni 8

Fusha e autoritetit te ortakut

Fusha e autoritetit të ortakut dhe përqindja e fitimeve ose humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e Shoqërisë, si dhe kompetencat që gëzon ortakut në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuara në këtë statut.

Neni 9

Libri i Shoqerise

Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, Shoqëria do të çelë librin e vet, i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.

Neni 10

Konfidencialiteti

Ortakut i vetëm si dhe personat e tjerë të pranuar në Shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

Neni 11

Dokumentet e destinuar per te tretet

Të gjitha aktet dhe dokumentet që nxirren nga Shoqëria dhe të destinuar për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme, etj. duhet të tregojnë lexueshëm emrin e Shoqërisë dhe pas tij fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "Sh.P.K.", si dhe emrin e administratorit.

KAPITULLI IV

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET DHE TRANSFERIMI I TYRE

Neni 12

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 1.000 \$ (një mijë dollare USA).





Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortakut i vetëm. Shoqëria mund ta shtojë ose zvogelojë kapitalin, në varesi të nevojave dhe rezultateve të saj, sipas vendimit të ortakut të vetëm.

Neni 13 Kontributet

Kapitali themeltar përbëhet nga kontributi i mëposhtëm :

Zoti Vebi Velija ka derdhur shumën prej 1.000 \$ (njëmijë dollare USA).

Neni 14 Pjeset e kapitalit themeltar

Kapitali themeltar është i ndarë në 20 pjesë plotësisht të shlyera, me vlerë 50 dollare USA secila, të renditura sipas numrit të serisë nga 1 në 20.

Neni 15 Lenia dhe transferimi i pjeseve të kapitalit

Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm tek personat e tretë, në qoftë se ortakut i vetëm vendos për këtë. Ai mund të lihet peng sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu kapitali themeltar është lirisht i trashëgueshëm në rrugë trashëgimie. Bashkeshortja, paraardhësit dhe pasardhësit mund të behen ortak nepermjet transferimit të pjeseve të kapitalit themeltar, me vendim të ortakut të vetëm dhe sipas kushteve që lejohen në ligj.

Transferimet e pjeseve të kapitalit themeltar duhet të behen me akt noterial.

KAPITULLI V STRUKTURA, ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 16 Ortakut i Vetem

Si organ i vetëm administrues, drejtues dhe përfaqësues i Shoqërisë është Ortaku i Vetëm i saj me iniciativën dhe kapitalin e të cilit vepron Shoqëria.

Neni 17 Kompetencat e Ortakut të Vetem

Per sa kohe qe Shoqeria do te perbehet nga nje ortak i vetem, kompetencat e tij do te jene:

Realizon administrimin, drejtimin dhe perfaqesimin e Shoqerise ne marrëdhëniet me persona te tjere juridike apo fizike.

Vendos per ndryshimet ne Statutin e Shoqerise dhe perpilon ose miraton rregulloret per Shoqerine apo per sektore te veçante te veprimtarise.

Vendos per politiken afariste te Shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saj.

Emeron dhe shkarkon administratoret e Shoqerise dhe detajon kompetencat e tyre te percaktuara ne Statut.

Kur e shikon te nevojeshme emerion drejtorin ekzekutiv te Shoqerise apo te sektoreve te vaçante te saj, duke caktuar ne aktin e emerimit edhe kompetencat e tij, kohezgjatjen ne pune etj..

Shqyrton bilancin vjetor, percakton llojet e fondeve te ndryshme dhe masen e tyre, fitimin e realizuar si dhe vendos per marrjen e kredive

Vendos per krijimin e degeve (filialeve) ose te perfaqesive si dhe per krijimin e shoqerive me persona te tjere fizike apo juridike.

Vendos per mbarimin e Shoqerise, likuidimin e saj si dhe per shnderrimin e Shoqerise nga shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri te formave te tjera.

Realizon marrëdhëniet me te rendesishme ekonomike dhe financiare te Shoqerise me persona te tjere fizike apo juridike, vendas apo te huaj.

Vendos çmimet e shitjes, te sherbimeve etj..

Vendos per pagat e te punesuarve ne Shoqeri.

Pervec kompetencave te lartepermendura, te cilat jane ekskluzive per te, Ortaku i Vetem ne rastet kur nuk ka emeruar administrator, kryen veprimet dhe ka kompetencat qe ne kete Statut jane percaktuar per administratorin.

Neni 18

Administratori dhe kompetencat e tij

Kompetencat e administratorit ose te administratoreve, ne menyre konkrete dhe te detajuar percaktohen ne aktin e tyre te emerimit. Vec te tjerave qe mund te detajohen ne kete akt, administratori ka edhe keto kompetenca:

Kujdeset per funksionimin e perditshem normal te Shoqerise ose te nje pjese te aktivitetit ekonomik dhe financiar te saj, sipas percaktimit ne aktin e emerimit.



Pergatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te Shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ia paraqet Ortakut te Vetem per shqyrtim.

Koordinon veprimtarine e personave te punesuar ne Shoqeri

Shqyrton ofertat dhe pergatit kerkesa te cilat ia paraqet Ortakut te Vetem per miratim.

Ndjek problemet e Shoqerise ne marredhenie me organet shtetore ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve

I propozon Ortakut te Vetem te Shoqerise cmimet e shitjes dhe te sherbimeve si dhe pagat per personelin e punesuar ne Shoqeri.

I propozon Ortakut te Vetem rregulloret per sektore te vecante te Shoqerise.

Emërimi i administratorit do të bëhet për tere periudhen e kohezgjatjes se Shoqerise, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm.

Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij.

KAPITULLI VI

LIBRAT E SHOQERISE, BILANCI, DIVIDENTET

Neni 19

Librat e Shoqerise


Shoqëria është e detyruar të mbajë, përveç Librit te Shoqërisë, në të cilin shënohet emri i plotë i ortakut dhe kapitali themeltar, si dhe vendimet e ortakut të vetëm, edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjerë.

Neni 20

Bilanci

Bilanci mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti, ku i pari do të jetë 31 dhjetori i vitit 1998.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël i autorizuar nga ortaku, miratohen nga ortaku i vetëm.



Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 21 Dividentet

Ortaku i vetem miraton llogarite vjetore dhe evidenton ekzistencën e fitimit. Ai përcakton fitimin e vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lena menjëherë për: rezervën sipas ligjit ose të përcaktuar nga vete ortaku; fondet e tjera që shihen të nevojshme dhe, nga ana tjetër i janë zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme. Kështu ortaku i vetëm përcakton dhe dividendin.

KAPITULLI VII MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 22 Mbarimi

Shoqëria mbaron me vendim të ortakut të vetëm ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

Neni 23 Likujdimi

Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi ortaku cakton një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

Në fund të procesit të likujdimit, ortaku i vetëm vendos mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit.

Mbas pagimit të kreditorëve ortaku i vetëm mban pjesën e mbetur të kapitalit.

KAPITULLI VII MOSMARREVESHJEVE DHE DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24 Zgjidhja e mosmarreveshjeve



Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare.

Neni 25
Dispozita te fundit


Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet në ndonjë Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë.

Shoqëria do të ketë vulën e saj, formën dhe madhësinë e së cilës do të përcaktohen nga presidenti.

Ky Statut është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore.

ORTAKU I VETEM

VEBI VELIJA



18624/2 3 5 14 6 5

KERKESE

KERKUES : Isuf DERVISHI, i dtl. 01. 01. 1968, i biri i Musait, lindur dhe banues ne Librazhd.

OBJEKTI : Depozitimi i vendimit te ortakut te vetem ne Regjistrin Tregtar.

PERPARA ; GJYKATES SE SHKALLES SE PARE

TIRANE

E nderuar Gjyrate!

